



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .07.2025

**MBLEDHJA Nr. 29,
Datë 17.07.2025, ora 10:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 17.07.2025, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 29 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 09.06.2025 dhe datë 27.06.2025.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
8. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.04.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “SOLAR HORIZON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW”.
9. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI